

2020  
#2

# RAPORTI MONITORUES

mbi punën e legjislativit të komunës  
së Lipjanit

**Dhjetor 2020**



COPYRIGHT © 2020. Youth Association for Human Rights (YAHR).

**Youth Association for Human Rights** i ka të rezervuara të gjitha të drejtat për këtë raport dhe asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të jetë objekt i riprodhimit ose bartjes në asnjë formë mekanike ose elektronike, duke përfshirë fotokopjimin ose ndonjë sistem të ruajtjes ose tërheqjes së materialeve pa autorizimin paraprak të botuesit me shkrim. Publikimi mund të riprodhohet ose të bartet vetëm për qëllime jo komerciale. Kurdo dhe kushdo që ka për qëllim të përdorë fragmente ose materiale të ndryshme të këtij publikimi, është i detyruar ta tregojë qartë burimin sa herë që janë nxjerrë fragmentet ose materialet e përdorura.

Nëse keni ndonjë koment, kritikë ose sugjerim, ju lutemi na kontaktoni përmes ndonjë prej opsioneve të mëposhtme:

Adresa: Rruga Tahir Sinani,

14000, Lipjan,

Kosovë

Tel .: +383 (0) 44 786 414

E-mail: info.yahr@gmail.com

Web:www.ngoyahr.webbly.com

**Autor:** Bekim Krasniqi

**Asistentë të hulumtimit:** Vildane Metushi

**Faqosja dhe dizajni:** YAHR

**Ky publikim është përgatitur nga Youth Association for Human Rights dhe përkrahur nga granti te Olof Palme International Center. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë te Autorit (ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Olof Palme International Center"**

## TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave .....	4
Hyrje.....	5
Përmbledhje ekzekutive.....	6
Qëllimet e monitorimi të punës së Kuvendi të Komunës së Lipjanit.....	7
Rekomandimet: .....	7
Dinamika e punës së Kuvendit .....	7
Lista e rregulloreve dhe planeve të shqyrtuara nga Kuvendi komunal të vitit 2020:	8
Lista e raporteve të shqyrtuara nga Kuvendi komunal të vitit 2020: .....	8
Lista e vendimeve komunale të miratuar gjatë vitit 2020:.....	8
Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave .....	9
Pyetje parlamentare.....	11
Inicimi i çështjeve .....	12
Burimet:.....	13

## LISTA E SHKURTESAVE

AAK	ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS
AKR	ALEANCA KOSOVA E RE
DCC	DEMOKRTASKA STRANKA
LDD	ALEANCA KOSOVA E RE
LDK	LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS
LVV	LËVIZJA VETËVENDOSJE
KK	KUVENDI KOMUNAL
ORA	PARTIA ORA
PAI	PARTIA ASHKALIVE PËR INTEGRIM
PD	PARTIA E DREJTËSISË
PDAK	PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKALIVE TË KOSOVËS
PDK	PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS
PSD	PARTIA SOCIAL DEMOKRATE
YAHR	YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS

Të nderuar qytetarë të Komunës së Lipjanit,

Organizata Joqeveritare YAHR- do të vazhdojë me monitorimin e aktiviteteve të legjislativit të Komunës së Lipjanit, gjatë periudhës katër vjeçare 2017/2021 dhe do të dal me raporte monitoruese- vlerësuese për çdo gjashtë muaj.

Youth Association for Human Rights /YAHR që nga vitit 2019 është duke bërë monitorimin pro aktiv të punës së kuvendit të Komunës së Lipjanit. Në monitorimin e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për periudhën gjashtë mujore, nëpërmes këtij raporti YAHR provon të kontribuoj në ofrimin e informacioneve të strukturuar të cilat do të jenë në shfrytëzim, para së gjithash për qytetarin e Komunës së Lipjanit, shoqërinë civile, mediat, si dhe vetë institucionin e monitoruar, Kuvendin e Komunës së Lipjanit.

Raporti monitorues për punën e legjislativit të Kuvendit komunal të Lipjanit, karakterizohet me zhvillime në interesante ku gjatë kësaj periudhe kemi edhe shfaqja e pandemisë me COVID 19. Me gjithë atë YAHR-i është munduar që të hartojë një raport, duke u mbështetur në shumë burime të informacionit: monitorimi i seancave të Kuvendeve Komunale, Komiteteve për Politikë dhe Financa, analizimit të dokumenteve të ndryshme si procesverbale dhe rendet e ditës, analizimi i raporteve të mediave të shkruara dhe elektronike, debatet si dhe diskutimet e organizuara nga shoqëria civile.

Bekim Krasniqi

Drejtor ekzekutiv i YAHR-it

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti monitorues është bazuar në monitorimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare nga monitoruesit të YAHR-së dhe nga materialet të ndryshme zyrtare të Komunës së Lipjanit siç janë; procesverbalet e seancave plenare, materialet për kuvendarë, video incizimet, transmetimet online të seancave plenare etj.

Gjatë periudhës korrik – dhjetor 2020, Kuvendi Komunal i Lipjanit i ka mbajtur gjithsej 6 seanca plenare, nga të cilat dy seanca të jashtëzakonshme. Kjo periudhë karakterizohet me probleme të shumta të shkaktuara nga situata me pandeminë COVID-19. Edhe pse është nxjerr një qarkore nga Ministria e Shëndetësisë lidhur me organizimin e tubimeve, ajo nuk është respektuar nga ana e kuvendareve dhe edhe nga vetë kryesuesi i Kuvendit Komunal. Të gjitha mbledhjet janë mbajtur në sallën e kuvendit komunal, duke mos i respektuar distancën fizike në mes ulësve të kuvendareve dhe masat tjera mbrojtëse. Salla ku janë mbajtur mbledhjet nuk i ka përmbushur aspak kriteret për organizimin e rregullt të një seance plenare, sepse nuk ka pasur hapësirë të mjaftueshëm të distancës në mes kuvendareve, për monitoruesit, gazetarët dhe qytetarët e interesuar, por për përcjelljen e punimeve të Kuvendit Komunal e ka mundur administrata komunale duke transmetuar drejtpërdrejtë në platformën YouTube.

Monitoruesit e YAHR e kanë vërejtur një pasivitet të theksuar të kuvendareve gjatë pikave të rendit të ditës të cilat kanë të bëjë me aprovimin e vendimeve, rregulloreve apo të raporteve, ku afër 40 % e kohës shfrytëzohet para fillimit të mbledhjes në pyetje dhe përgjigje nga kuvendarët dhe nga ana e ekzekutivit, ku kemi edhe raste që vendimet, rregulloret apo raportet miratohen pa asnjë diskutim nga ana e kuvendareve, e cila është kjo një pa përgjegjësi e tyre karshi qytetareve.

Subjektet politike me aktive në diskutime gjatë kësaj periudhe raportuese ishin: subjekti politik i PDK-së me 41 diskutime ose me 44.57 %, pastaj kemi një ngjitje të subjektit politik të LVV-së me 22 diskutime ose 25 %, i treti për nga pjesëmarrje në diskutime i takojnë dy subjekteve politike LDK-së dhe AKR-së me nga 10 diskutime ose 10.87 %, pastaj vjen AAK-ja me diskutime 5 ose 5.43 %, AKR-ja me 18 diskutime ose 7.65 %, PD me 2 diskutime ose 2.17 % dhe NISMA me asnjë. Ndërsa, Kuvendaret më aktivë të kësaj periudhe kanë qenë: Lulzim Rustemi nga PDK-ja me 152 pikë, Albulena Kelmendi nga LVV-ja me 78 pikë dhe Afrim Miftari nga AKR-ja me 60 pikë, kuvendarët kuvendarët jo aktiv ishin: Arif Miftari , Mehmetali Krasniqi, Fadil Sopa, Naim Jahiri , Ramadush Tasholli, Fatime Krasniqi, Hezide Rustemi nga subjekti politik LDK-së, Hajdin Bytyqi dhe Safete Amerllahu nga subjekti politik AKR dhe Egzona Fazlija nga NISMA.

Sikur edhe në periudhat e kaluara edhe në këtë periudhë kuvendarët lipjanas të Kuvendit Komunal janë aktiv në ngritjen e problemeve dhe çështjeve që i shqetësojnë qytetarët e komunës së Lipjanit. Përfaqësuesit e PDK-së janë më aktiv me gjithsej 17 çështje të ngritura për ekzekutivin e komunës ose 54.84 % nga totali i çështjeve të ngritura, pastaj vijnë përfaqësuesit e subjektit LVV-së me 5 çështje ose 16.13 %, AKR-së me 4 ose 12.90 %, AAK-ë dhe PD me 2 ose 6.45 %, NISMA me 1 ose 3.23 %, LDK-ja dhe PAI me asnjë çështje të ngritur.

Në këtë periudhë të gjashtë mujorit të dytë 2020, kemi një angazhim aktiv të kuvendareve në parashtrimin e pyetjeve drejtuar ekzekutivit lidhur me shumë çështje që i atakon drejtpërdrejt interesat e qytetareve. Përfaqësuesit e PDK-së janë më aktiv duke ju falënderuar angazhimit veçmas të kuvendarit Lulzim Rustemit dhe Argjend Tashollit, të cilët kanë parashtruar gjithsej 12 pyetje për ekzekutivin e komunës ose 46.15 % nga totali i pyetjeve, pastaj vijnë përfaqësuesit e subjektit LVV-së me 7 pyetje ose 26.92 %, AAK-së me 4 ose 15.38 %, LDK-së me 2 ose 7.69 %, PD me 1 ose 3.85 %, NISMA dhe AKR-ja me asnjë pyetje.

## QËLLIMET E MONITORIMI TË PUNËS SË KUVENDI TË KOMUNËS SË LIPJANIT

YAHR në tentativë për të adresuar interesat dhe brengat e qytetarëve në mënyrë të paanshme dhe apartiake u ofron qytetarëve informata në mënyrë të vazhdueshme. Synimi i monitorimit të punës së zyrtarëve të zgjedhur është ndërtimi i një shoqërie të qëndrueshme demokratike.

## REKOMANDIMET:

- Krijimi apo gjetja e mundësive alternative të mbajtjes së seancave të Kuvendit Komunal nëse vazhdohet me një gjendje të tillë me pandeminë COVID-19,
- Të sigurohen mjetet mbrojtëse për pjesëmarrësit në seanca nga pandemia COVID-19,
- Pyetjet nga ana kuvendareve të parashtrihen në formën e shkruar dhe në të njëjtën formë të merren edhe përgjigjet nga ana e ekzekutivit komunal e gjithë kjo për shkak kursimit të kohës.
- Një përgjegjësi më të madhe të Kuvendareve ndaj interesave të qytetarëve me pjesëmarrje aktive në diskutime rreth rregulloreve, vendimeve apo raporteve dhe të mos harrohet se ata janë aty për të përfaqësuar interesat e qytetarëve, e jo interesat individuale apo edhe partiake.
- Një opozitë me e zëshme për artikullimin e interesave të qytetarëve karshi ekzekutivit të Komunës së Lipjanit.

## DINAMIKA E PUNËS SË KUVENDIT

Gjatë periudhës korrik – dhjetor 2020, pjesëmarrja në diskutime e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Lipjanit në lidhje me pikat e rendit të ditës është karakterizuar me problemet rreth pandemisë me COVID 19.

Kuvendaret më aktivë të kësaj periudhe kanë qenë: LULZIM RRUSTEMI PDK 152 pikë, ALBULENA KELMENDI LVV 78 pikë, AFRIM MIFTARI AKR 60 pikë, RAMIZ QERIQI PDK 49 pikë, SHKELZEN BISLIMI LVV 48 pikë, ARGJENT TASHOLLI PDK 43 pikë, LUMTURIJE BYTYQI HASANI PDK 33 pikë, BASHKIM BUDAKOVA AAK 28 pikë, ALBAN SALIHULVV 26 pikë, NAZMI KRASNIQI PDK 25 pikë, HYRA BYTYÇI LDK 23 pikë, ARBEN SALIHUPDK 23 pikë, NEHAT TËRPEZA LDK 22 pikë, UKË KRYEZIU AAK 18 pikë, EGZONA BYTYQI PDK 14 pikë, MANUSH SHAMOLLI NISMA 5 pikë, NAIM STULLCA LDK 4 pikë, MAJLINDA SYLEJMANI LDK 4 pikë, GANIMETE QERIQI AAK 4 pikë, FEHMI REXHEPI PAI 4 pikë, ndërsa pas njw pikw janw: ARIF MIFTARI , MEHMETALI KRASNIQI, FADIL SOPA, NAIM JAHIRI , RAMADUSH TASHOLLI, FATIME KRASNIQI , HEZIDE RUSTEMI nga subjekti politik LDK-ë, HAJDIN BYTYQI dhe SAFETE AMERLLAHU nga subjekti politik AKR dhe EGZONA FAZLIJA nga NISMA

**Tabela 1: Renditja e Kuvendareve bazuar në angazhimet e tyre nëpër seanca plenare të Kuvendit të Lipjanit**

	Kuvendari	Subjekti politikë	pikët		Kuvendari	Subjekti politikë	pikët
1	LULZIM RRUSTEMI	PDK	152	<b>16</b>	MANUSH SHAMOLLI	NISMA	<b>5</b>
2	ALBULENA KELMENDI	LVV	78	<b>17</b>	NAIM STULLCA	LDK	<b>4</b>
3	AFRIM MIFTARI	AKR	60	<b>18</b>	MAJLINDA SYLEJMANI	LDK	<b>4</b>
4	RAMIZ QERIQI	PDK	49	<b>19</b>	GANIMETE QERIQI	AAK	<b>4</b>
5	SHKELZEN BISLIMI	LVV	48	<b>20</b>	FEHMI REXHEPI	PAI	<b>4</b>



6	ARGJENT TASHOLLI	PDK	43	21	ARIF MIFTARI	LDK	0
7	LUMTURIJE BYTYQI HASANI	PDK	33	22	MEHMETALI KRASNIQI	LDK	0
8	BASHKIM BUDAKOVA	AAK	28	23	FADIL SOPA	LDK	0
9	ALBAN SALIHU	LVV	26	24	NAIM JAHIRI	LDK	0
10	NAZMI KRASNIQI	PDK	25	25	RAMADUSH TASHOLLI	LDK	0
11	HYRA BYTYÇI	LDK	23	26	FATIME KRASNIQI	LDK	0
12	ARBEN SALIHU	PDK	23	27	XHEZIDE RUSTEMI	LDK	0
13	NEHAT TËRPEZA	LDK	22	28	HAJDIN BYTYQI	AKR	0
14	UKË KRYEZIU	AAK	18	29	SAFETE AMERLLAHU	AKR	0
15	<b>EGZONA BYTYQI</b>	<b>PDK</b>	<b>14</b>	30	<b>EGZONA FAZLIJA</b>	<b>NISMA</b>	<b>0</b>

LISTA E RREGULLOREVE DHE PLANEVE TË SHQYRTUARA NGA KUVENDI KOMUNAL TË VITIT 2020:

- Rregullore për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit
- Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksat komunale 15Nr.434-79235 të datës 20.12.2019.
- Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullore për ndarjen e bursave për student të Komunës së Lipjanit 15Nr.670-19941 e datës 29. 05. 2020.

LISTA E RAPORTEVE TË SHQYRTUARA NGA KUVENDI KOMUNAL TË VITIT 2020:

- Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2020.
- Raporti gjashtëmuor Janar-Qershor 2020 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale
- Shqyrtimi-diskutimi i Raportit të auditimit të jashtëm dhe Plani i zbatimit të rekomandimeve të auditorit
- Raporti i performancës së komunës së Lipjanit për vitin 2019,
- Raporti i shpenzimeve Janar-Shtator 2020
- Raport të Punës të Sektorit për Personel Janar-Nëntor 2020.

LISTA E VENDIMEVE KOMUNALE TË MIRATUAR GJATË VITIT 2020:

- Vendim për vënien në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit 2020-2028.
- Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës
- Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve.
- Vendim për trajtimin e parceles kadastrale P-71409044-01745-0 në procesin e shqyrtimit publik dhe finalizimin të dokumentit të ardhshëm të planifikimit hapsinor Harta Zonale e Komunës së Lipjanit.
- Vendim mbi bartjen e rezervës komunale 2020
- Vendim mbi Ridestinimin dhe Transferin e mjeteve të Buxhetit për vitin 2020
- vendim mbi aprovimin e Buxhetit për vitet 2021-2023.
- Vendim për zëvendësimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve
- Vendim mbi bartjen e rezervës komunale 2020
- Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 15Nr.400-19921 të datës 29. 05. 2020 për ndarjen e mjeteve financiare për punëtorët e komunës së Lipjanit që kanë punuar në teren gjatë pandemisë Covid-19.
- Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës 1Nr. 110623 i datës 26.09. 2008
- Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021,

- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare
- Vendim për miratimin e Planit të Integritetit 2021-2022
- Vendim për shpalljen e lokalitetit të Boshtrës (Forsythia Europea) Golesh si zonë e mbrojtur
- Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës.
- Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan.


## PJESËMARRJA NË DISKUTIME GJATË SEANCEVE

Gjatë kësaj periudhe monitoruese korrik – dhjetor 2020, subjektet politike me aktive në diskutime gjatë seanceve plenare ishte subjekti politik i PDK-së me 41 diskutime ose me 44.57%, pastaj kemi një ngjitje të subjektit politik të LVV-së me 22 diskutime ose 25%, i treti për nga pjesëmarrje në diskutime i takojnë dy subjekteve politike LDK-së dhe AKR-së me nga 10 diskutime ose 10.87%, pastaj vjen AAK-ja me diskutime 5 ose 5.43%, AKR-ja me 18 diskutime ose 7.65%, PD me 2 diskutime ose 2.17% dhe NISMA me asnjë

**Tabela 2: Pjesëmarrja e subjekteve politike gjatë seanceve plenare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit**

Subjekti politik	Propozim për rend dite		Pjesëmarrja në diskutime gjatë seanceve			Pjesëmarrja në diskutime në emër të grupit të anëtarëve			Inicimi i çështjeve		Pyetjet parlamentare				
	Piket	%													
LDK	0	0	%	10	10.87	%	3	75	%	0	0.00	%	2	7.69	%
PDK	3	100	%	41	44.57	%	1	25	%	17	54.84	%	12	46.15	%
LVV	0	0	%	23	25.00	%	0	0	%	5	16.13	%	7	26.92	%
AKR	0	0	%	10	10.87	%	0	0	%	4	12.90	%	0	0.00	%
AAK	0	0	%	5	5.43	%	0	0	%	2	6.45	%	4	15.38	%
NISMA	0	0	%	0	0.00	%	0	0	%	1	3.23	%	0	0.00	%
PD	0	0	%	2	2.17	%	0	0	%	2	6.45	%	1	3.85	%
PAI	0	0	%	1	1.09	%	0	0	%	0	0.00	%	0	0.00	%

### Pjesëmarrja në diskutime gjatë seanceve



**Tabela 3: Pjesëmarrja e Kuvendareve gjatë seancave plenare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit**

KOMUNA E LIPJANIT		Subjekti politik	Propozim për rend dite	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve	Inicimi i çështjeve	Amandamenti I legjislacionit	Inicimi I rregulloreve	Pyetjet parlamentare	Mungesa në seanca	Gjuha jo parlamentare	Gjithsej pike
<b>Deputetët</b>												
	<b>ARIF MIFTARI</b>	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	<b>NAIM STULLCA</b>	LDK	0	4	0	0	0	0	0	0	0	4
	<b>DAUT AZEMI</b>	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	<b>MEHMETALI KRASNIQI</b>	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	<b>NEHAT TËRPEZA</b>	LDK	0	20	2	0	0	0	0	0	0	22
	<b>FADIL SOPA</b>	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	<b>NAIM JAHIRI</b>	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	<b>RAMADUSH TASHOLLI</b>	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	<b>HYRA BYTYÇI</b>	LDK	0	12	1	0	0	0	10	0	0	23
	<b>FATIME KRASNIQI</b>	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	<b>XHEZIDE RUSTEMI</b>	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	<b>MAJLINDA SYLEJMANI</b>	LDK	0	4	0	0	0	0	0	0	0	4
	<b>LULZIM RRUSTEMI</b>	PDK	6	96	0	20	0	0	30	0	0	152
	<b>RAMIZ QERIQI</b>	PDK	0	24	0	20	0	0	5	0	0	49
	<b>ARGJENT TASHOLLI</b>	PDK	0	12	1	25	0	0	5	0	0	43
	<b>NAZMI KRASNIQI</b>	PDK	0	20	0	5	0	0	0	0	0	25
	<b>LUMTURIJE BYTYQI HASANI</b>	PDK	0	8	0	5	0	0	20	0	0	33
	<b>EGZONA BYTYQI</b>	PDK	0	4	0	10	0	0	0	0	0	14
	<b>ALBAN SALIHU</b>	LVV	0	16	0	10	0	0	0	0	0	26
	<b>SHKELZEN BISLIMI</b>	LVV	0	28	0	5	0	0	15	0	0	48
	<b>ALBULENA KELMENDI</b>	LVV	0	48	0	10	0	0	20	0	0	78
	<b>AFRIM MIFTARI</b>	AKR	0	40	0	20	0	0	0	0	0	60
	<b>HAJDIN BYTYQI</b>	AKR	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	<b>SAFETE AMERLLAHU</b>	AKR	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	<b>BASHKIM BUDAKOVA</b>	AAK	0	8	0	5	0	0	15	0	0	28
	<b>UKË KRYEZIU</b>	AAK	0	8	0	5	0	0	5	0	0	18
	<b>GANIMETE QERIQI</b>	AAK	0	4	0	0	0	0	0	0	0	4
	<b>MANUSH SHAMOLLI</b>	NISMA	0	0	0	5	0	0	0	0	0	5
	<b>EGZONA FAZLIJA</b>	NISMA	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0


<b>ARBEN SALIHU</b>	PDK	0	8	0	10	0	0	5	0	0	23
<b>FEHMI REXHEPI</b>	PAI	0	4	0	0	0	0	0	0	0	4

## PYETJE PARLAMENTARE

Në këtë periudhë të gjashtë mujorit të dytë 2020, kemi një angazhim aktiv të kuvendareve në parashtrimin e pyetjeve drejtuar ekzekutivit lidhur me shumë çështje që i atakon drejtpërdrejt interesat e qytetareve. Përfaqësuesit e PDK-sw janë më aktiv duke ju falënderuar angazhimit veçmas të kuvendarit Lulzim Rustemit dhe Argjend Tashollit, të cilët kanë parashtruar gjithsej 12 pyetje për ekzekutivin e komunës ose 46.15 % nga totali i pyetjeve, pastaj vijnë përfaqësuesit e subjektit LVV-së me 7 pyetje ose 26.92 %, AAK-së me 4 ose 15.38 %, LDK-së me 2 ose 7.69 %, PD me 1 ose 3.85 %, NISMA dhe AKR-ja me asnjë pyetje.

**Tabela 4: Pjesëmarrja e subjekteve politike në pyetjeve parlamentare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit**

Subjekti politik	Pyetjet parlamentare		
	Numri	Përqindje	Shprehje
LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	2	7.69	%
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	12	46.15	%
LËVIZJA VETËVENDOSJE	7	26.92	%
ALEANCA KOSOVA E RE	0	0.00	%
ALEANCA PËR ARDHMERINË E KOSOVËS	4	15.38	%
NISMA	0	0.00	%
PARTIA E DREJTËSISË	1	3.85	%
PARTIA ASHKALINJVE PËR INTERGRIM	0	0.00	%




## INICIMI I ÇËSHTJEVE

Sikur edhe në periudhat e kaluara edhe në këtë periudhë kuvendaret lipjanas të Kuvendit Komunal janë aktiv në ngritjen e problemeve dhe çështjeve që i shqetësojnë qytetarët e komunës së Lipjanit. Përfaqësuesit e PDK-së janë më aktiv me gjithsej 17 çështje të ngritura për ekzekutivin e komunës ose 54.84 % nga totali i çështjeve të ngritura, pastaj vijnë përfaqësuesit e subjektit LVV-së me 5 çështje ose 16.13 %, AKR-së me 4 ose 12.90 %, AAK-ë dhe PD me 2 ose 6.45 %, NISMA me 1 ose 3.23 %, LDK-ja dhe PAI me asnjë çështje të ngritur.

**Tabela 5: Pjesëmarrja e subjekteve politike në Inicimi i çështjeve në Kuvendin e Komunës së Lipjanit**

Subjekti politik	Inicimi i çështjeve		
	Numri	Përqindje	Simboli
LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	0	0.00 %	
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	17	54.84 %	
LËVIZJA VETËVENDOSJE	5	16.13 %	
ALEANCA KOSOVA E RE	4	12.90 %	
ALEANCA PËR ARDHMERINË E KOSOVËS	2	6.45 %	
NISMA	1	3.23 %	
PARTIA E DREJTËSISË	2	6.45 %	
PARTIA ASHKALINJVE PËR INTERGRIM	0	0.00 %	



## BURIMET:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Korrik - Dhjetor 2020.
2. Monitorimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve komunale nga zyrtaret e YAHR-it, Korrik - Dhjetor 2020
3. Raportet mujore të drejtorive komunale të Komunës së Lipjanit, Korrik - Dhjetor 2020,.
4. Komunikatat për media të YAHR-it Korrik - Dhjetor 2020.
5. Ekstraktet nga mbledhjet e Kuvendit Komunal , Korrik - Dhjetor 2020,
6. <http://kk.rks-gov.net/Lipjan/>
7. <https://www.youtube.com/channel/UCmDXxB6d1n6gXGtEiowljQQ>



